

VENDIM
Nr.89, datë 27.1.2009

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
KROACISË, PËR NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN PËR MARRËDHËNIET
EKONOMIKE, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për ndryshimet në marrëveshjen për marrëdhëniet ekonomike, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN MBI
MARRËDHËNIET EKONOMIKE DYPALËSHE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
KROACISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Qeveria e Republikës së Kroacisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (këtu quajtur “Palët Kontraktuese”),

në lidhje me Marrëveshjen mbi marrëdhëniet bilaterale ekonomike ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfunduar në Zagreb, më 10 maj 1993 (këtu të quajtur “Marrëveshja”),

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Neni 2 i Marrëveshjes shfuqizohet.

Neni 2

Neni 8 i Marrëveshjes shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 10 të Marrëveshjes, paragrafët 3,4,5 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 4

Pas nenit 10 të Marrëveshjes, shtohet neni i ri 10 a që lexon si më poshtë:

“Neni 10 a

Që nga data e aderimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin European, kjo Marrëveshje zbatohet pa cenuar detyrimet që rrjedhin nga kjo anëtarësi. Për pasojë, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të citohen ose interpretohen në një mënyrë të tillë që të zhvlerësojnë ose ndryshe të ndikojnë mbi detyrimet e vendosura nga Traktati i Bashkimit European dhe Marrëveshja e Stabilizim Asocimit ndërmjet Bashkimit European dhe Republikës së Shqipërisë, të nënshkruar në Luksemburg, më 12 qershor 2006.

Për më tepër, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të citohen apo interpretohen në një mënyrë të tillë që të zhvlerësojnë ose ndryshe të ndikojnë në detyrimet që rrjedhin nga traktatet ndërkombëtare që do të lidhen, duke zëvendësuar marrëveshjet e mësipërme.”.

Neni 5

Kjo Marrëveshje mbi ndryshimin hyn në fuqi në datën e aderimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin European, në të cilën Republika e Kroacisë, në kohën e duhur, do të informojë Republikën e Shqipërisë, me kusht që në atë datë Palët Kontraktuese të kenë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Nëse Palët Kontraktuese nuk njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme në datën e aderimit të Republikës së Kroacisë në Bashkimin European, kjo Marrëveshje mbi ndryshimet hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nëpërmjet të cilët Palët Kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Bërë në _____ më dy kopje origjinale, secila në kroatisht, shqip dhe anglisht, ku të gjithë tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretim, teksti në anglisht mbizotëron.